



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-3899 2025

Datë: 05.10.2025 2025

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë , Nenit 6 dhe paragrafit 6 të nenit 9 të Ligjit 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Nenit 40 nën pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa , Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 20.01.2025 me nr. prot. 01Nr.401-2075/2025, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2025 të mbajtur më datën: 31.01.2025 , mori këtë :

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, bartjen dhe shpërndarjen e tyre nga viti 2024 në vitin 2025 në shumë prej **181,127.71 €**.

2. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 1 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nën-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:

- 2.1 Mallra dhe Shërbime në shumën prej **50,000.00 €**;
- 2.2 Shpenzimet Komunale në shumën prej **80,000.00 €**;
- 2.3 Shpenzime Kapitale në shumën prej **51,127.71€**.

3. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 2 pika 2.1 të këtij vendimi në kategorinë mallra dhe shërbime:

Buxhetimi (17518), shuma prej 50,000.00 €;

Arsyetim: Mjetet e destinuar në kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime, në shumën prej 50,000.00 €, do të përdoren për pagesën e obligimeve të papaguara.

4. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 2 pika 2.3 të këtij vendimi në kategorinë e shpenzimeve komunale:

Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej 50,000.00 €;
Administrata e arsimit (92090) shuma prej 30,000.00 €.

Arsyetim: Mjetet e destinuar në kategorinë ekonomike të Shpenzimeve komunale, në shumën prej 80,000.00 €, do të përdoren për mbulimin e obligimeve të pashlyera për shkak të nxemjeve qendrore me pompa termike dhe zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik.

5. Shuma e mjeteve financiare si në nenin 2 pika 2.4 të këtij vendimi në kategorinë e shpenzimeve kapitale shpërndahen:

Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët”, kodi (56106), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj”, kodi (56059), shuma prej 11,127.71 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Volljake-Sferke-Qupeve-Dush”, kodi (56084), shuma prej 20,000.00 €;

Arsyetim: Mjetet në kategorinë e shpenzimeve kapitale në shumën prej **51,127.71 €**, do të përdorën për mbulimin e obligimeve kontraktuara, vazhdimin e projekteve të pa përfunduar.

6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.


Kryesues i Kuvendit
Fadi Gashi